



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA KAÇANIK



Opština Kaçanik/ Municipality of Kaçanik

Nr. 01-104/02-2830/25

Datë : 03.02.2025

Në zbatim të nenit 12, paragrafi 2, pika d, të Ligjit 03/ L-040 Për Vetëqeverisjen Lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës Kosovës", Nr. 28/ 2008), Vendimit të Kuvendit të Komunës 01 Nr.400/01-21277/24 të datës 30.09.2024- për Miratimin e Buxhetit të Komunës së Kaçanikut për vitin fiskal 2025, Rregullores MF- NR- 04/2017 mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ- ve dhe Rregullorës Komunale Nr.06/2016 për kushtet, kriteret dhe procedurat e ndarjes së subvencioneve, KOMUNA E KAÇANIKUT nxjerr këtë :

VENDIM

PËR SHPALLJEN E THIRRJES PUBLIKE PËR MBËSHTETJE FINANCIARE PUBLIKE PËR PROJEKT / PROGRAME TË ORGANIZATAVE JO-QEVERITARE NË FUSHËN E KULTURËS, RINISË DHE SPORTIT PËR VITIN 2025

I

1. Për implementimin e thirrjes publike do të zbatohen dispozitat e rregullores MF- NR- 04/2017 mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve dhe Rregullorës Komunale Nr.06/2016 për kushtet, kriteret dhe procedurat e ndarjes së subvencioneve.
2. Mbështetja financiare publike në vlerë të tridhjetëmijë euro (30,000.00€) për projektet/programet e OJQ-ve për realizimin e projekteve në fushën e kulturës,do të ofrohet nga Buxheti i Komunës së Kaçanikut-subvencione dhe transfere të DKRS, kodi ekonomik 21200 në kuadër të programit/nënprogramit 85028/shërbime kulturore.
3. Mbështetja financiare publike në vlerë të tetëdhjetëmijë euro (80,000.00€) për projektet/programet e OJQ-ve për realizimin e projekteve në fushën e rinisë dhe sportit, do të ofrohet nga Buxheti i Komunës së Kaçanikut-subvencione dhe transfere të DKRS, kodi ekonomik 21200 në kuadër të programit/nënprogramit 85028/shërbime kulturore.

II

1. Mjetet e përmendura në nenin I, pika 2 do të shpërndahen në bazë të thirrjes publike për financimin e projekteve të OJQ-ve në fushën e kulturës, rinisë dhe sportit , sipas dokumentacionit për zbatimin e thirrjes, e cila është pjesë përbërëse e këtij vendimi.

III

1. Dokumentacioni për zbatimin e thirrjes sipas pikës II. të këtij vendimi përbëhet:
 - a) Teksti i thirrjes publike
 - b) Udhëzimet për aplikantët
 - c) Formularët e aplikimit
 - d) Forma për vlerësimin e cilësisë së projekteve
 - e) Format për raportimin e zbatimit të projektit

2. Formularët e aplikimit referuar në paragrafin 1 të këtij neni janë:
- Forma e përshkrimit të programit apo projektit
 - Forma e buxhetit të programit apo projektit
 - Forma e deklaramentit të mungesës së fondeve të dyfishta
 - Deklarata e Partneritetit (nëse është e aplikueshme)
 - Forma e deklaratës së programeve apo projekteve të OJQ-ve të financuara nga burimet publike
 - Deklarata për aktivitetet e kontraktorit e përmendur në përshkrimin e aktiviteteve të projektit që janë të njohur me programin ose projektin dhe pjesëmarrjen e tyre në zbatim (nëse aplikohet)
3. Formularët për zbatimin dhe raportimin e projekteve të referuara në paragrafin 1 të këtij neni janë:
- Forma e kontratës për financimin e programit apo projektit
 - Formulari për përgatitjen e raportit narrativ për projektin apo programin
 - Formulari për përgatitjen e raportit financiar të programit apo projektit

IV.

Thirrja publike dhe dokumentacioni për zbatimin e thirrjes dhe kërkesës së aplikimit do të publikohen në mënyrë të plotë në faqen e internetit të Komuna e Kaçanikut

V.

- Në përputhje me Rregulloren MF- NR- 04/2017 për kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik për OJQ-të, udhëzuesit për aplikantët dhe Rregullorës Komunale Nr.06/2016 për kushtet, kriteret dhe procedurat e ndarjes së subvencioneve, Komuna e Kaçanikut / Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit do të krijojë një Komision Vlerësues për hapjen dhe regjistrimin e aplikacioneve si dhe verifikimin e kushteve të përcaktuara të thirrjes publike.
- Komisioni vlerësues do të bëjë vlerësimin e përmbajtjes së aplikacioneve të projekteve të pranuar që kanë përmbushur me sukses kushtet formale për të qenë pjesë e konkurrimit sipas paragrafit 1 të këtij neni.
- Anëtarët e Komisionit Vlerësues do të punojnë në përputhje me procedurën e përcaktuar në Udhëzimet për aplikuesit dhe rregullat e parapara me rregulloren MF- NR- 04/2017 për financimin publik të OJQ-ve dhe dhe Rregullorës Komunale Nr.06/2016 për kushtet, kriteret dhe procedurat e ndarjes së subvencioneve

VI.

- Pasi të merret vendimi mbi aplikuesit e suksesshëm, projektet e të cilëve i plotësojnë kushtet për financim, Komuna e Kaçanikut merr vendim për ndarjen e mjeteve për financimin e projekteve/programeve të OJQ-ve.
- Ofruesi i mbështetjes financiare do të njoftoj përfituesit për kohën e nënshkrimit të kontratave.
- Përgjegjës për zbatimin e këtij vendimi është Komuna e Kaçanikut / Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Drejtoria për Buxhet dhe Financa .

IX.

Ky vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit

